



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Security Code" Sh.P.K. të datës 23.11.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së në Prishtinë - e negociuar - Ritender " me nr. të prokurimit 616-24-11945-2-1-5, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Security Code" Sh.P.K. të datës 23.11.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së në Prishtinë - e negociuar - Ritender " me numër të prokurimit 616-24-11945-2-1-5, ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Security Code" (tutje "parashtruesi") me datë 23.11.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së në Prishtinë - e negociuar - Ritender " me nr. të prokurimit 616-24-11945-2-1-5.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 -

AK Pretendon se ne si OE nuk e kemi plotësuar siq duhet Listen e çmimeve dhe me arsyetimin duke pretenduar ne shkelje ka eliminuar oferten tone sit e papergjegjshme.

Ky pretendim nuk qendron për faktin që ne me date 13.11.2024 jemi ftuar për negociim dhe nga komisioni na është kërkuar sqarim për pozicionin ore shtese sipas nevojave , gje që ne jemi rekomanduar që duke qene se ofrojmë çmimin 2.80 euro me TVSH për njësi nese paraqitet nevoja shteses ta ngarkojme pas perfundimit te negociatave , dhe një gje te tille e kemi ber menjher ne sistem e-prokurimit kemi ngrit çmimin sipas kërkesës, kjo gje vertetohet ne sistem.

Ky dokument është ngarkuar ne sistem para shpalljes fitues për ne si OE , pra para vendimit dhe konsiderohet që ne kuptim te nenit 72 Informacione shtese ne kemi permbushur dhe sqaruar oferten për AK. AK gjate rivlersimit me qellim nuk ka marre ne konsiderate kete process.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se nuk është kontestues fakti që parashtruesi ka ndryshuar paramasën pas përfundimit të negociatave lidhur me pozicione të caktuara në paramasë. Mirëpo në ofertën financiare të ngarkuar me rastin e ofertimit, parashtruesi në pozicionin nr. 22 nuk ka vendosur fare çmim. Sipas UPP në rast se mungon çmimi në paramasë kjo përbën kusht administrativ dhe oferta si e tillë menjëherë duhet të trajtohet si e papërgjegjshme pa nevojën që të kërkohe sqarime shtese. Fakti që pas përfundimit të negociatave parashtruesi ka ndryshuar paramasën (duke plotësuar çmimin e munguar për pozicionin përkatës të paramasës) përbën ndryshim material të ofertës dhe nuk është i lejuar. Rrjedhimisht oferta e parashtruesit si e tillë është ofertë e papërgjegjshme ndërsa pretendimi ankimor i pabazuar.

Pretendimi nr. 2 -

Duke shpërblyer me kontrate OE Syri Group i cili ne ofertën e tij , ka plotësuar Listën e çmimit , në pozicionin numër 21 ne listën e çmimeve ka ofertuar çmimin njësi me tvsh 3.728 , që do te thotë se është ne kundërshtim me ligjin e prokurimit , kjo vlene te potencohet ne rastin e vlerësimit te pare nga ana e komisionit i cili ka vlerësuar ne mënyrë te drejt ofertën e OE Security Code si te përgjegjshme dhe oferta me çmimin me te lire.

AK ka vepruar kundërligjshëm dhe duke vlerësuar ne mënyrë jo te drejte ka diskriminuar ofertën e Security Code shpk , sepse udhëzues me te cilin ju referohet AK që nëse nuk ofrohet çmimi ne një pozicion , oferta eliminohet , ne te njëjtin udhëzues që gjeni te bashkangjitur thuhet decidivisht që nëse çmimi i ofertuar ka me shume se dy numra pas presjes dhjetor automatikisht eliminohet oferta si e pa përgjegjshme.

Vlene te përmendet se AK ne këtë procedure ka vepruar kundërligjshëm duke vlerësuar ne mënyrë jo te barabarta dhe ka shkelur neni 7 te LPP-se paragrafin 1 dhe 2 .

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se parashtruesi në listën e çmimit në pozicionin nr. 21 ka ofertuar çmimin 3,278 përkatësisht ka dorëzuar çmim me 3 numra pas presjes dhjetore. Sipas nenit 17.11. të RRPP është përcaktuar se "të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme". Nga ky këndvështrim ky pretendim ankimor është i bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.11.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.